



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org.Jednica Org.Unit	<u>DL</u>
Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No:	<u>1799-2/26</u>
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	<u>02</u>
Data. Datum: Date:	<u>27.04.2026</u>
PRISHTINË/A	

Për:	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH VL 63/26 Datë: 22.04.2026
Zyrtarët përgjegjës:	1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës

I nderuar kryetar Muharremaj,
I nderuar kryesues Kuçi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 08.04.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), **Rregullorën për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës**

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Suharekës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës

ARSYETIMI

MMPH, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë dhe në pajtim me nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka konstatuar se:

- Në preambulë, ndër të tjera, të citohet: "...në zbatim të nenit 15 lidhur me nenin 34 të Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina..."-Rekomandohet që këto dispozita të citohen veç e veç, përkatësisht duke i referuar në mënyrë të pavarur secilit nen.
- Tek neni 3 (Përkufizimet) i rregullores, paragrafi 3.21 "Licencë për menaxhimin e mbeturinave" duhet të fshihet, pasi që kjo kategori nuk është më e paraparë në legjislacionin në fuqi. Bazuar në nenin 4, paragrafi 3 të Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, është ndryshuar përkufizimi përkatës në ligjin bazik, duke zëvendësuar përkufizimin "Licencë për menaxhimin e mbeturinave" me "Leje përkatëse mjedisore". Mbajtja e këtij përkufizimi në rregullore nuk është në përputhje me dispozitat e ligjeve të mbeturinave në fuqi.
- Në nenin 7, paragrafi 1- të shtohet referenca edhe në Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina.
- Në nenin 16, paragrafët 16.2 dhe 16.3- është përsëritur dy herë referenca në Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina. Të korrigjohet kjo përsëritje.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave.

